

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË AKSIONARE  
"OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA" SHA**

1. Në Tiranë, sot më 29 Shkurt 2024, u hartua Akti i themelimit të shoqërisë "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 7.9.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë".

2. Autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, është Ministria përgjegjëse për ekonominë.

3. Znj. Arlinda Pogaj, Drejtor i shoqërisë "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, vepron si përfaqësues ligjor i shoqërisë.

4. Formohet shoqëria tregtare "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, e cila do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe hqoëritë tregtare" të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.531, datë 7.9.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë", Aktin e themelimit dhe me Statutin e saj.

5. Shoqëria "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha e ka selinë në adresën Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bly. "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri.

6. Shoqëria "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha është person juridik dhe funksion në bazë të ligjit nr.9901, datë "Për tregtarët dhe hqoëritë tregtare" të ndryshuar.

7. Objekti i shoqërisë "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha është kryerja e procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës. Shoqëria "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve si më poshtë vijon:

- blerje automjetesh;
- blerje karburanti, me përjashtim të vajgurit Jet A1 dhe karburantit që prokurohet për përdorim nga fermerët;
- blerje materialesh kancelarie;
- blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim;
- blerje materialesh të ndryshme për pastrim;
- blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;

- blerje këpucësh;
- blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
- blerje tonerash;
- shërbime në fushën e sigurimeve, si:
  - o sigurim i automjeteve;
  - o sigurim i mjeteve lundruese;
  - o sigurim i mjeteve ajrore;
  - o sigurim jete dhe shëndeti;
  - o sigurim i godinave publike;
- shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;
- shërbim pastrimi;
- shërbim lavanderie;
- shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike;
- riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;
- botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
- blerje materialesh të buta dhe veshmbathjesh;
- riparim e mirëmbajtje sistemesh të ngrohje-ftohjeve;
- blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjete didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore;
- shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi;
- blerje artikujsh ushqimorë;
- blerje pajisjesh kondicionimi;
- shërbim gjelbërimi;
- rikonstruksion objektsh.

9. Kohëzgjatja e shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha do të jetë pa afat të caktuar.

10. Kapitali themeltar i shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha është 20,000,000 (njëzet milion lekë) lekë dhe është i ndarë në 20,000 (njëzetmijë) aksione me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secili. Vlera e kapitalit fillestar do të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit i Shtetit.

11. Aksionet janë lirisht të transferueshme sipas akteve ligjore në fuqi. Kapitali i shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha mund të rritet apo të zvogëlohet, sipas modaliteteve të përcaktuara në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar .

12. Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon në ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2023.

13. Anëtarët e parë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha janë:

- a) Znj. Lira Pipa
- b) Z. Sokol Ismaili
- c) Znj. Alketa Pernaska
- d) Znj.Elinda Pupla
- e) Z.Edmond Ahmeti
- f) Z.Sokol Bardhi

14. Audituesit e parë ligjor të shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha janë;

- a) Ilda Duhaxhiu,
- b) Klodiana Ngjeçi.

15. Ky Akt themelimi për shoqërinë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sha përpilohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

**AKSIONAR I VETËM**

**MINISTRI I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**

**BLENDI GONXHJA**

